



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 426/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesat e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Zef Morina nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja më datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Zef Morinës kandidat për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga subjekti politik LDK dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Zef Morina të subjektit politik LDK me nr.110 nga Prishtina, me të cilën pretendohet se në vendvotimin VV 0222C/01R një numër i madhë i votave të mia janë manipuluar në mënyrë të vrazhdë. Më tutja ka shtuar se në të njëjtin vendvotim 35 votat që më janë dhënë nga ana e votuesve më pastaj janë fshirë dhe në vend të kësaj janë shënuar 15 vota. Pra edhe në vendvotimin VV 0205C/03R numëri prej 3 votave është fshirë dhe është shënuar 0 vota. Në listën e rezultateve të votimit nr.0223C/02R vërehet ndërhyrje në rezultatet e votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se kërkoi që ndaj komisionerëve të ndërrmeren masa ligjore si dhe të rinumërohen të gjitha votat duke mos llogaritur kutit të cilat janë rinumëruar.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar kopjet e FRK-së.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë : *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme.”* Andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet-Zef Morina me nr. 110 të subjektit politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin

e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për votat për të cilat pretendon në ankesë se në vendvotimet 0222C/01R, 0205C/03R, 0223C/02R është manipuluar me votat e tij duke mos ju shënuar në FRK numri i saktë i votave të fituara

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 0222C//01R për Komunën e Gjakovës e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 115257, 115250, 115258, 115259, ndërsa shiriti i mesëm me numër 139281 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 115256. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 011459 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 321637, 321638, 321639 dhe 321640, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-it ka konstatuar nga origjinali i Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FRK), që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 110 nga radhët e subjektit politik LDK, i posedon 15 vota, ndërsa pas hapjes së kutisë së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve lidhur me kandidatin në fjalë prapë rezultojnë se i njëjti i posedon 15 vota në vendvotimin 0222C/01R e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se posedon më shumë vota.

Ekipi hetues i PZAP-it po ashtu ka hapur kutinë e votimit me numër 0205C/03R për Komunën e Gjakovës e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 0034699, 0034698, 0034697, 0034696, ndërsa shiriti i mesëm me numër 139281 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 115256. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë pa numër dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 0010335, 0010332, 0010333 dhe 0010334, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-it ka konstatuar nga origjinali i Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FRK), që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 110 nga radhët e subjektit politik LDK, i posedon 3 vota e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se posedon më shumë vota.

Për më tepër ekipi hetues i PZAP-it, e ka hapur kutinë e votimit 0205C/03R, dhe i ka numëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatit në fjalë dhe pas numërimit të votave rezulton se i njëjti i posedon 3 vota siç edhe kanë qenë në FRK origjinal në QNR dhe dhe po ashtu të njëjtat vota janë të përfshira në rezultatin përfundimtar për kandidatin nr.110 nga radhët e subjektit politik LDK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur edhe kutia e votimit me numër 0223C/02R për Komunën e Ferizajt e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 115563, 115565, 115562, 115564, ndërsa shiriti i mesëm me numër 115561 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 115582. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 0010350 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 0010346, 0010347, 0010348 dhe 0010349, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-it ka konstatuar nga origjinali i Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FRK), që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 110 nga radhët e subjektit politik LDK, i posedon 2 vota e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se posedon më shumë vota.

Për më tepër ekipi hetues i PZAP-it, e ka hapur kutin e votimit 0223C/02R, dhe i ka numëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatit në fjalë dhe pas numërimit të votave rezultojnë se i njëjti i posedon 2 vota siç edhe kanë qenë në FRK origjinal në QNR dhe jo siç ka pretenduar ankuesi se ka më shumë vota, po ashtu të njëjtat vota janë të përfshira në rezultatin përfundimtar për kandidatin nr.110 nga radhët e subjektit politik LDK.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 426/2014 më datën 30.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Herit Osmani



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*